

TURIZMI MALOR

Qarku i Lezhës ka mjaft pasuri turistike ekologjike, malore dhe alpine.

Ndër pasuritë e këtij turizmi mund të veçojmë: pyjet, burimet, bimësinë, monumentet e natyrës etj. Këto pasuri shfaqen në një sipërfaqe prej 93 264 ha, në zonën kodrinore dhe malore të qarkut.

Masivet malore të shumta me lartësi të mëdha mbi nivelin e detit, me pyjet, livadhet dhe burimet, krijojnë bukuri të rralla dhe mundësi për zhvillimin e turizmit malor dhe alpin, kryesisht në bjeshkët karakteristike si: Kunorë, Munellë, Orosh, Selitë, Xhuxhë (në Mirditë), Trodhne (në Kurbin), Malung dhe Velë (në Lezhë).

Interesante shfaqet Mirdita e nëndheshme, jo vetëm për pasuritë nëntokësore e për zgafellat që hapi dora e njeriut, por edhe për shpellat karstike që gjenden në malet e kësaj krahine si :

Shpella e Valit, Komuna Kthellë,
Shpella e Mërkurthit në fshatin Mërkurth të Selitës (e pa eksploruar deri tani),
Shpella e Fretërve në Lufaj të Selitës,
Shpella e Akullit në Orosh,
Gurra e Domgjonit në Komunën Fan,
Shpella e Fatmirave në komunën Selitë,
Shpella e Shutrresë në Grykë të Selitës.

Turistët e aventurës, por edhe speleologët, të cilët nuk kanë munguar t'i eksplorojnë këto shpella pas viteve 90-të, që janë një destinacion befasues turistik.

Kurbini dhe Mirdita, por dhe pjesa malore e Lezhës ka adresime të këtij turizmi.

Ndër bukuritë natyrore dhe me vlera kurative është Kroji i Bardhë në Bjeshkët e Kunorës dhe të Valmorit (në Selitë Mirditë). Është ujë kurativ për shumë sëmundje të ndryshme ndaj dhe vizitohet jo vetëm nga vendas por dhe turistë të huaj.